



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
QENDRA KOMUNITARE MULTIDISCIPLINARE

Nr prot.

Tiranë, më _____, 2023

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM DHE SHERBIME ME USHQIM PER
MENCEN”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Ushqime të përgatitura: 15894200-3

Biskota të embla : 15821200-1

Ujë I pijshëm : 41110000-3

Fruta Perime: 15300000-1

Qumësht I pasterizuar : 15511100-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,791,328 (dy milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e tetë) **lek pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Qendra Komunitare Multidisiplinare** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe

miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Ne zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licensuar sipas dispozitave perkatëse ligjore dhe nen ligjore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar; VKM nr.539, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nenligjore të përbashkëta” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e furnizimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Operatorët Ekonomik duhet të zbatojnë kërkesat e Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të kenë xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit që prokurohet

- b. Bilancet e viteve 2021, 2022, 2023 duhet të jenë Konfirmuara nga Organi Tatimor. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit
- c. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB

Dokumentacioni që vërteton kapacitetin ekonomik dhe financiar do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit nga ofertuesi i kualifikuar i pari, me kërkesë të autoritetit kontraktor.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.*

Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Licence Profesionale për ushtrimin e aktivitetit me objekt përpunim dhe shpërndarje e ushqimit e vlefshme, lëshuar nga QKB, II.1.A(1).

2.3.2 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a. Kur shërbimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur Kontraten e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni Shtetëror, për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate.
- b. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me:

- a. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë HACCP (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) ose ekuivalente me të.
- b. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 22000: 2018 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) ose ekuivalente me të.
- c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) ose ekuivalente me të.

***Argumentimi:**Në bazë të nenit 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”te ndryshuar dherekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018. Kjo kerkese eshte e lidhur ngushtesisht me objektin e prokurimit dhe eshte e rendesishme qe operatori ekonomik te ofroje siguri ushqimore gjate zbatimit te kontrates.*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar (Deklarate nga Administratori i shoqërisë) ne stafin e tij **7 persona** pjesë e tyre profesionist si: 2 Kuzhinier , 2 ndihmës /kuzhinier, 1 merceolog , 2 punonjës shërbimi/shofer të nevojshem per realizimin e shërbimit të ushqimit

Stafi i mësipërm sipas pikës 2.3.5 duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, (shtator,tetor,nentor).

Dokumentacioni që verteton disponimin e punonjesve do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit nga ofertuesi i kualifikuar i pari ,me kërkesë të autoritetit kontraktor.

Nr	Personeli	Sasia
1	Kuzhinier	2
2	Merceolog	1
3	Ndihmes Kuzhinier	2
4	Punonjës shërbimi/shofer	2
Total		7

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”te ndryshuar dhe dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Konkretisht: Referuar natyres se objektit qe prokurohet eshte e nevojshme pasja e nje stafi te kualifikuar. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes per realizimin e objektit.Operatori ekonomik duhet te disponoje nje person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit te gatitmi dhe shprendarjes se ushqimit pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se kyperson përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi I kerkuar duhet te jete I kualifikuar dhe me experience ne fushen e objectit te prokurimit.*

2.3.5 Deklarate nga Operatori ekonomik se disponon në pronësi ose me qera një mjet transporti qe kryhen transportin e produkteve ushimore, produkteve frigoriferike, per te gjith periudhen e realizimit te shërbimit objekt prokurimi.

Dokumentacioni që verteton disponimin e mjetit të transportit të nevojshëm për kryerjen e shërbimit (si më poshtë) do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit nga ofertuesi i kualifikuar i pari, me kërkesë të autoritetit kontraktor.

a. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qirasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes. b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre. c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese). f) Leje higjieno-sanitare për automjetin, leshuar nga Drejtoria e Shëndetit Publik e rrethit ku ushtron aktivitetin përkatës, e vlefshme për periudhën e realizimit të objektit të kontratës.

2.3.5. i. Pajisje isobox termike antibakteriale për të mundësuar transportin e ushqimit nga mjete të transportit brenda ambienteve të institucionit. Deklarate nga Operatori ekonomik se disponon në pronësi pajisje isobox.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar dhe dherekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të ushqimeve të gatuar për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është gatimi dhe shpërndarja e ushqimit, pra operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë të ushqimit të miratuar, nga Autoriteti Kontraktor, sipas normës bazë të ushqimit, sipas standardeve tekniko-teknologjike si dhe ta shpërndaj në ambientet e autoritetit kontraktor konform kërkesave të Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambientet e përcaktuara nga autoriteti

kontraktor, si dhe për ruajtjen e higjienës dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike. Është e nevojshme disponimi i nje mjeti transporti frigoriferik për ruajtjen e nivelit kulinar të ushqimit dhe temperaturën optimale me qëllim shmangien e mundësisë për kontaminimin e ushqimit gjate transportit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje te pakten 1 ambient ku ushtron veprimtarine e sherbimit dhe gatimit te ushqimit. Per te plotesuar kete pike operatori ekonomike duhet te paraqese:

- a. Dokumentacionin qe verteton pronesine ose marrjen me qera te ketij ambienti per aktivitetin prodhim dhe shperndarje te ushqimit catering.
- b. Lejen nga QKL per pelqim mjedisor per aktivitetin e gatimit dhe shperndarjes se ushqimit.
- c. Leje higjeno - sanitare per objektin ne fjale.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion ambjenti, mjetet dhe pajisjet e posacme për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është gatimi dhe shpërndarja e ushqimit, pra operatori ekonomik do të bëjë gatimin e produkteve ushqimore sipas menisë të ushqimit të miratuar, nga Autoriteti Kontraktor, konform normës bazë të ushqimit, sipas standardeve tekniko-teknologjike dhe për këtë është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.

- a. Për këtë duhet të paraqesi vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga Autoritet në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.3.8 Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka për detyrim të paraqesi dokumentacion provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetin konform kërkesave ligjore.

Shënim: Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, përpara lidhjes së kontratës me autoritetin kontraktor ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues në lidhje

me kontrollin e fundit të ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për të provuar ushtrimin e aktivitetit konform kërkesave ligjore.

*Argumentimi: Në bazë të nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”
dherekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018.. Kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke shërbyer për autoritetin kontraktor për njohjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Në zbatim të nenit 36, 37 të LPP-se në të gjitha rastet kur permendet “markë” përfshihet termi “ekuivalent”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.